



## **RREGULLORE PËR FUNKSIONIMIN E ZYRËS PËR MBËSHTETJEN E STUDENTËVE DHE KËSHILLIMIN E KARRIERËS NË UNIVERSITETIN POLIS**

### **NENI 1 Objekti**

Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore në zbatim të tij, Statutit dhe Rregullores së Përgjithshme të Universitetit Poliss.

### **NENI 2 Baza ligjore**

Kjo rregullore ka për objekt rregullimin e veprimtarisë administrative të Zyrës për Mbështetjen e Studentëve dhe Këshillimin e Karrierës (ZMSKK), si dhe këshillimin e karrierës së studentëve në përputhje me objektivat e saj.

Këshillimi i karrierës është një proces ndërpersonal projektuar për të ndihmuar individët në çështjet e zhvillimit të karrierës

### **Neni 3 Qëllimi**

Qëllimi ZMSKK si strukturë në vetvete është i orientuar drejt mbajtjes së kontaktit të vazhdueshëm si dhe dhënies së informacionit shumëdrejtimesh. Informacioni përmbledh informacion për studime, programe të ndryshme, orientim për karrierën ose orientimin profesional si dhe këshillim individual ose në grup.

### **Neni 4 Funksioni i zyrës**

Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) është një njësi, e cila asiston dhe ndjek studentët, si gjatë kohës së ndjekjes së studimeve, ashtu edhe pas mbarimit të saj, duke krijuar një database me të dhëna për karrierën, suksesin dhe vështirësitë e studentëve gjatë përshtatjes në treg, arritjet e tyre, lobimin për mbrojtjen e të drejtave të profesionit, përmes shoqatës AUA (Unioni i Arkitektëve, Urbanistëve dhe Planifikuesve Urbanë), ruajtjen e lidhjes me POLIS përmes Shoqatës ALUMNI, inkurajimin e frymës së bashkëpunimit si komunitet, mbështetjes dhe filantropisë.

### **Neni 5 Detyrat kryesore**

Veprimtaritë dhe detyrat kryesore të Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës janë:

- Informimi i studentëve dhe sigurimi i transparencës së plotë për çështjet e aspektet akademike, mësimore dhe shkencore si dhe me të drejtat e detyrat e tyre;
- Orientimi i studentëve në shkollimin dhe gjatë shkollimit për zgjedhjen e fushave formuese specifike dhe mundësive të formimit që ofron universiteti;
- Orientimi dhe njohja e studentëve me tregun e punës në përgjithësi dhe mundësitë e veçanta e të momentit për punësimin duke ndërmjetësuar këtë proces;
- Të mbajë kontakte individuale me studentët edhe pas diplomimit e punësimit të tyre duke marrë në mënyrë të vazhduar feedbackun e tyre;
- Të kryejë studime të përditësuara të tregut të punës dhe identifikimin e kërkesave të tij dhe ti vërë ato në dispozicion të studentëve.
- Rregullon dhe siguron përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, në proceset e aktivitetet kryesore që lidhen me mësimdhënien dhe aktivitetet e tjera kërkimore e





- zhvilluese si dhe shërbimet që u ofrohen.

#### **Neni 6**

##### **Bashkëpunimi me strukturat e tjera**

Kjo zyrë bashkëpunon ngushtë me Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK):

- drejtuesit e Shoqatës Studentore dhe të Shoqatës Alumni.
- bashkëpunon ngushtë me departamentet e fakulteteve për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve të U\_POLIS.
- mban komunikim me tregun e punës për të tërhequr mendime sa i takon përputhjes së diplomave të ofruara me tregun e punës, si dhe për të lehtësuar procesin e praktikave.
- mban marrëdhënie të vazhdueshme me shoqatat apo organizime të tjera të Alumnit dhe i mbështet ato në funksionimin e tyre.
- ndihmon studentët në krijimin e lidhjeve me punëmarrësit potencial.
- shërben si burim rekrutimi për shumë organizata dhe institucione dhe të ofrojë shërbime trajnimi për biznese të ndryshme.
- në bashkëpunimin me strukturat drejtuese të U\_Polis, fakulteteve, departamenteve dhe stafit akademik e ndihmës-akademik, ofron për studentët: workshope; trajnime; info day; takime të hapura, etj.

#### **Neni 7**

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore miratohet, ndryshohet ose shfuqizohet me aprovimin e shumicës së anëtarëve të Senatit Akademik.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë mbas aprovimit.

